



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 126 Nr. i faq./Br.str./No pg 01/23

Data/Datum/Data 30.08.2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.08.2023, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 02/1057/23, i datës 4.8.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur *Rakita*, zona kadastrale Xërxë, parcela me numër P-71510033-01015-1 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna Rahovec, me sipërfaqe prej 134m<sup>2</sup> (njëqind e tridhjetë e katër metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 28918m<sup>2</sup> (njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë metra katror), **I JEPET** në posedim Sulejman (Hamdi) Kryeziut, ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510033-01015-12 në posedim të Sulejman (Hamdi) Kryeziu, me sipërfaqe prej 134m<sup>2</sup> (njëqind e tridhjetë e katër metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6000m<sup>2</sup> (gjashtë mijë metra katror), **I JEPET** në posedim Komunës Rahovec, në emër të këmbimit për zgjerimin e rrugës publike.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është për interes publik, për zgjerimin e rrugës publike dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. **OBLIGOHET** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbjës, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.126/23**  
**Më datë:30.08.2023**

